

Banka e Shqipërisë

Departamenti i Politikës Monetare



Rezultatet e Vrojimit të Biznesit dhe të Konsumatorit


Tetor 2011

Treguesi i ndjesisë ekonomike¹

Treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE) shënoi një rritje të lehtë me rreth 0.6 pikë përqindjeje në tremujorin e tretë të vitit 2011. Niveli aktual i TNE-së (87.9) qëndron rreth 12.1 pikë përqindjeje poshtë mesatares së tij afatgjatë.

Përmirësimi aktual i TNE-së u përcaktua nga zhvillimet relativisht pozitive në treguesit përbërës të tij. Përmirësimi i besimit në sektorin e shërbimeve, të industrisë dhe në atë të ndërtimit kontribuan pozitivisht në TNE. Në të njëjtin drejtim ndikoi dhe rritja e besimit të konsumatorëve.

Grafik 1. Treguesi i ndjesisë ekonomike.




Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe Vrojtimi i Besimit të Konsumatorëve, Banka e Shqipërisë.

¹ Duke filluar nga tremujori i dytë i vitit 2011, në treguesit e besimit të biznesit janë bërë dy ndryshime: (i) kampioni mbi të cilin ndërtohet treguesi i besimit në shërbime (TBSH) është rritur në 200 ndërmarrje që veprojnë në këtë sektor, duke përjashtuar tregtinë; (ii) për tregtinë është ndërtuar një kampion i ri dhe po punohet për ndërtimin e një treguesi besimi specifik për këtë sektor. Aktualisht, në TNE nuk përfshihet sektori i tregtisë.

Sektori i industrisë

Treguesi i besimit në industri (TBI) shënoi një përmirësim të lehtë me rreth 1.2 pikë përqindjeje në tremujorin e tretë të vitit 2011, pas përkeqësimit të shënuar në tremujorin e mëparshëm. Gjatë këtij tremujori, niveli i TBI-së qëndroi rreth 1.7 pikë përqindjeje nën mesataren e tij afatgjatë. Përmirësimi i TBI-së është shkaktuar nga vlerësimi më pak negativ për situatën e *prodhimit industrial*, balanca e të cilit u rrit me 7.6 pikë përqindjeje. Shtimi i gjendjes së *inventarëve* ka kontribuar negativisht në treguesin e agreguar. Gjithashtu, në të njëjtin drejtim ndikoi dhe përkeqësimi, me rreth 4.3 pikë përqindjeje i balancës së *situatës së punësimit* në sektorin e industrisë.

Grafik 2: Treguesi i besimit të industrisë (në pikë përqindje).



Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit, Banka e Shqipërisë.

Në vijim, analiza e disa treguesve që nuk përfshihen në ndërtimin e TBI:

Bizneset e sektorit të industrisë kanë vlerësuar në rënie *ecurinë e ekonomisë* në total dhe *gjendjen e përgjithshme të bizneseve* të tyre, gjatë tremujorit të tretë të vitit 2011. Megjithatë, edhe pse balancat përkatëse vijojnë të jenë negative, ato shënuan përmirësim me përkatësisht 1.5 dhe 6.0 pikë përqindjeje, në krahasim me tremujorin e kaluar. Në përgjithësi, të gjithë faktorët që kufizojnë aktivitetin e bizneseve të industrisë, kanë ndikuar në një shkallë më të ulët në këtë aktivitet, krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2011. Veçanërisht, *problemet me energjinë elektrike, korrupsioni, ekonomia informale, gjendja e rendit dhe e sigurisë* në vend, si dhe *klima e brendshme politike* kanë ulur ndikimin negativ në aktivitetin e bizneseve të industrisë. Nga ana tjetër, vihet re një rritje e ndikimit negativ shkaktuar nga *kuadri ligjor dhe zbatueshmëria e tij*, që pengojnë zhvillimin e aktivitetit normal në këtë sektor.

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2011, *kërkesa e brendshme* për produkte industriale vijoi të vlerësohet negativisht edhe pse në një nivel më të ulët, krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Nga ana tjetër, *kërkesa e jashtme* për të njëjtën periudhë është vlerësuar pozitivisht. Bizneset në sektorin e industrisë kanë raportuar për rritje të *çmimeve të prodhimit* në tremujorin e tretë të vitit 2011. Balanca përkatëse rezultoi 10.9 për qind nga 9.4 për qind që ishte në tremujorin e kaluar. Në linjë me zhvillimet e kërkesës dhe të çmimeve të

prodhimit, në tremujorin e tretë të vitit 2011 *gjendja financiare* e bizneseve të industrisë vijon të paraqitet e përkeqësuar, edhe pse në një nivel më të ulët krahasuar me tremujorin e mëparshëm.


Norma e *shfrytëzimit të kapaciteteve* në industri pësoi rënie të lehtë, me rreth 0.5 pikë përqindjeje krahasuar me tremujorin e kaluar, duke shënuar nivelin 72.4 për qind në tremujorin e tretë të vitit 2011. Kjo normë qëndron rreth 1.7 pikë përqindjeje mbi mesataren e saj afatgjatë. Rreth 70.9 për qind e bizneseve të këtij sektori mendojnë se niveli aktual i shfrytëzimit të kapaciteteve të prodhimit është i mjaftueshëm, duke marrë parasysh kërkesën aktuale dhe pritjet për kontratat e porositë e 12 muajve të ardhshëm. Për 9.7 për qind të bizneseve, niveli aktual i shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese nuk është i mjaftueshëm.

Pritjet e sektorit të industrisë për tremujorin e katërt të vitit 2011 janë optimiste. Bizneset në këtë sektor presin përmirësim të *gjendjes së përgjithshme* të biznesit, rritje të *kërkesës së brendshme* dhe të *jashtme* dhe ulje të *inventarëve*. Gjithashtu, bizneset presin rritje të *prodhimit* dhe përmirësim të *situatës së punësimit*, në tremujorin e katërt të vitit 2011.

Sektori i ndërtimit

Treguesi i besimit në ndërtim (TBN) u përmirësua me rreth 3.5 pikë përqindjeje në tremujorin e tretë të vitit 2011. Edhe pas përmirësimit të lehtë në tremujorin aktual, TBN vijon të jetë thellësisht negativ. Zhvillimet në TBN u shkaktuan nga vlerësimi më pak negativ i *situatës së punësimit* dhe i *kërkesës* nga bizneset ndërtuese. *Situata e prodhimit* në sektorin e ndërtimit vijon të vlerësohet negativisht dhe pothuajse në të njëjtin nivel si në tremujorin e dytë të vitit 2011. Niveli aktual i TBN-së është shumë i ulët në krahasim me mesataren e tij afatgjatë. Ai qëndron rreth 12.8 pikë përqindjeje poshtë saj.

Grafik 3: Treguesi i besimit të ndërtimit (në pikë përqindjeje).



Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit, Banka e Shqipërisë.

Në vijim, analiza e disa treguesve që nuk përfshihen në ndërtimin e TBN:

Në tremujorin e tretë të vitit 2011, bizneset ndërtuese kanë ulur vlerësimin e tyre për *situatën e përgjithshme ekonomike në vend* dhe kanë vijuar të vlerësojnë negativisht *gjendjen e*

përgjithshme të biznesit të tyre. Rënia e optimizimit të bizneseve të ndërtimit është shkaktuar nga ndikimi negativ që shkaktojnë problemet e lidhura me *kuadrin ligjor dhe zbatueshmërinë e tij, korrupsionin dhe ekonominë informale. Problemet me energjinë elektrike, marrëdhëniet me bankat dhe situata politike e brendshme* janë ndër faktorët e vlerësuar në një shkallë më të ulët nga bizneset e industrisë, si faktorë që pengojnë aktivitetin normal të tyre.


Pavarësisht vlerësimit negativ të situatës së prodhimit, bizneset e ndërtimit kanë raportuar se shkalla e shfrytëzimit të kapaciteteve ndërtuese në tremujorin e tretë të vitit 2011 është 66.9 për qind, vetëm 0.2 pikë përqindjeje nën mesataren afatgjatë. Krahasuar me tremujorin e mëparshëm, kjo normë e shfrytëzimit të kapaciteteve rezulton rreth 0.7 pikë përqindjeje më e lartë. Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2011, rreth 64.3 për qind e bizneseve të sektorit të prodhimit shprehen se niveli aktual i shfrytëzimit të kapaciteteve është i mjaftueshëm, duke konsideruar nivelin e kërkesës dhe kontratat dhe porositë për 12 muajt e ardhshëm. Ndërkohë, për rreth 18.5 për qind të bizneseve në këtë sektor, ky nivel nuk është i mjaftueshëm. Ndër faktorët kryesorë që pengojnë shfrytëzimin e kapaciteteve në ndërtim, bizneset vlerësojnë *pamjaftueshmërinë e kërkesës dhe kufizimet financiare*. Në tremujorin e tretë të vitit 2011, bizneset në sektorin e ndërtimit shprehen për rritje të *çmimeve të prodhimit dhe rritje të gjendjes së inventarëve*. Bazuar në opinionet e bizneseve të ndërtimit, *gjendja financiare* e tyre vijon të vlerësohet negativisht edhe pse në një nivel më të ulët krahasuar me tremujorin e mëparshëm.

Pritjet për aspekte të ndryshme të biznesit si *prodhimi, kërkesa dhe punësimi* në tremujorin e katërt të vitit 2011 janë pozitive. Gjithashtu, bizneset në sektorin e ndërtimit presin zhvillime pozitive në aktivitetin e tyre gjatë tremujorit të katërt të vitit 2011.

Sektori i shërbimeve

Treguesi i besimit në shërbime (TBSH), u rrit me rreth 3.0 pikë përqindjeje gjatë tremujorit të tretë të vitit 2011. Përmirësimi i TBSH-së gjatë këtij tremujori, u përcaktua nga zhvillimet në tre balancat përbërëse të tij.

Grafik 4: Treguesi i Besimit në Shërbime (në pikë përqindjeje).



Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit, Banka e Shqipërisë.

Kontributin kryesor në përmirësimin e treguesit e dha vlerësimi mbi *situatën financiare*. Balanca përkatëse shënoi 10.0 për qind, duke u rritur me 7.3 pikë përqindje krahasuar me tremujorin e kaluar. Vlerësimi pozitiv i bizneseve mbi *gjendjen e punësimit*, ndonëse lehtësisht më i ulët se në tremujorin e kaluar (0.1 pikë përqindjeje), kontribuoi pozitivisht në rritjen e treguesit të besimit. Balanca e *gjendjes së përgjithshme të biznesit* është përmirësuar me 1.8 pikë përqindje në tremujorin e tretë, ndonëse vijon të mbetet negative. Aktualisht, niveli i TBSH-së, qëndron rreth 0.3 pikë përqindje mbi mesataren afatgjatë, për të parin tremujor që nga tremujori i tretë i vitit 2010.

Në vijim, analiza e disa treguesve që nuk përfshihen në ndërtimin e TBSH-së:

Bizneset e sektorit të shërbimeve kanë vlerësuar negativisht *situatën e përgjithshme ekonomike në vend* gjatë tremujorit të tretë të vitit 2011. Balanca përkatëse shënoi rënie me rreth 3.7 pikë përqindjeje krahasuar me tremujorin e mëparshëm. *Kuadri ligjor dhe institucional* vlerësohet si faktori kryesor pengues i zhvillimit normal të aktivitetit në sektorin e shërbimeve. Faktorët e tjerë si *klima e brendshme politike, dhe korrupsioni e ekonomia joformale* ndikuan në një masë më të vogël në pengimin e aktivitetit normal të sektorit të shërbimeve krahasuar me tremujorin e mëparshëm.

Kërkesa në sektorin e shërbimeve vijoi të vlerësohet negativisht edhe gjatë tremujorit të tretë të vitit 2011. Balanca përkatëse shënoi nivelin -1.6 për qind, nivel ky lehtësisht më i ulët krahasuar me atë të një tremujori më parë. Për tremujorin e tretë të vitit bizneset e fushës së shërbimeve vlerësojnë në rritje *çmimet* e këtij sektori. Balanca përkatëse shënoi 5.1 përqind nga 2.9 për qind që ishte në tremujorin e kaluar. *Norma e shfrytëzimit të kapaciteteve*, gjatë tremujorit të tretë të vitit 2011, rezultoi 78.5 për qind. Kjo normë është rreth 3.9 pikë përqindjeje më e lartë krahasuar me tremujorin e mëparshëm dhe rreth 3.5 pikë përqindjeje mbi mesataren afatgjatë.


Për tremujorin e katërt 2011, bizneset në sektorin e shërbimeve janë optimiste për *aktivitetin ekonomik të firmës*. Pritjet për *situatën e përgjithshme ekonomike* dhe *kërkesën* në këtë sektor janë pozitive, ndonëse më të ulëta se ato të tremujorit të kaluar.

Besimi i konsumatorëve

Treguesi i besimit të konsumatorëve (TBK) vijoi të rritet në tremujorin e tretë të vitit 2011 për të dytin tremujor radhazi. Pasi u rrit me 2.2 pikë përqindje në tremujorin e dytë, TBK shënoi rritje me 1.8 pikë përqindje në tremujorin e tretë. Përmirësimi i besimit konsumator gjatë këtij tremujori u ndikua kryesisht nga përmirësimi i balancës mbi *blerjet në shumën të mëdha*. Ndonëse negative, në tremujorin aktual, kjo balancë shënoi një përmirësim të ndjeshëm me 10.4 pikë përqindje. Balanca mbi *gjendjen aktuale financiare* të familjeve ka qëndruar në të njëjtin nivel me tremujorin e dytë të vitit. Në drejtim të kundërt kanë ndikuar rënia në balancën e pritjeve mbi *situatën financiare të familjeve* në tremujorin e ardhshëm. Balanca përkatëse shënoi nivelin 6.3 për qind, në rënie me rreth 1.5 pikë përqindje krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Gjithashtu, negativisht ndikoi dhe përkeqësimi me rreth 1.6 pikë

përqindje në balancën e pritjeve për gjendjen e përgjithshme ekonomike në tremujorin e katërt të vitit 2011.

Grafik 5. Treguesi i Besimit të Konsumatorëve (në pikë përqindjeje).



Burimi: Vrojtimi i Besimit të Konsumatorëve, Banka e Shqipërisë.

Në vijim, analiza e disa treguesve që nuk përfshihen në ndërtimin e TBK-së:

Në tremujorin e tretë të vitit 2011, vlerësimi i konsumatorëve për *situatën financiare të familjeve* dhe *situatën e përgjithshme ekonomike në vend* rezultoi më pak negativ krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Balancat përkatëse rezultuan në -1.2 dhe -7.4 për qind, në përmirësim me rreth 4.9 dhe 6.0 pikë përqindjeje. *Kostoja mesatare e jetesës* në tremujorin e tretë 2011 vlerësohet të mos ketë ndryshuar, krahasuar me tre muaj më parë. *Çmimet* pritet të rriten në tremujorin e ardhshëm dhe të rriten disi gjatë 12 muajve në vijim. Në gjashtëmujorin e ardhshëm, konsumatorët presin rënie të nivelit të papunësisë.

Bazuar në vlerësimet sasiore të konsumatorëve për normën e inflacionit pas 12 muajsh, vlera e pritur rezultoi 2.22 për qind, rreth 0.2 pikë përqindjeje më e lartë se ajo e shprehur në tremujorin e kaluar.

Tabelë 1: Treguesit e besimit sipas sektorëve*.

	Vlerat që nga T2-2002			2010				2011			Situata aktuale	
	min.	mes.	maks.	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	Konjunkturale**	Strukturore***
Industri	-18.0	-2.5	6.1	-7.8	-5.6	-7.7	-2.4	-0.6	-5.4	-4.2	⤴	-
Ndërtim	-21.8	-5.2	9.4	-17.0	-12.8	-22.2	-11.6	-10.2	-21.2	-17.7	⤴	--
Shërbime	-9.5	3.7	21.3	8.4	6.5	4.9	3.0	-5.1	1.0	3.9	⤴	+
Konsumator	-20.5	-12.3	-7.0	-13.4	-7.0	-8.7	-10.3	-13.4	-11.3	-9.4	⤴	+

Burimi: Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

*) Me përjashtim të treguesit të konsumatorit, treguesit janë llogaritur nga balanca të rregulluara sezonalisht.

**) Situata krahasuar me tremujorin e mëparshëm.

***) Situata për secilin tregues konsiderohet shumë e kënaqshme (+ +) kur treguesi është më shumë se 1 devijim standard më i lartë se mesatarja; situata konsiderohet e kënaqshme (+) kur treguesi është më pak se 1 devijim standard më i lartë se mesatarja; situata konsiderohet e pakënaqshme (-) kur treguesi është më pak se 1 devijim standard më i ulët se mesatarja; dhe situata konsiderohet shumë e pakënaqshme (--)) kur treguesi është më shumë se 1 devijim standard më i ulët se mesatarja.


Tabelë 2: Balancat kryesore të sektorëve të ekonomisë (në pikë përqindje)*.

	2010				2011			
	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4-pritje
Kërkesa								
Total	-3.2	-2.7	-5.8	-1.3	-4.4	-10.5	-8.1	18.7
Industri	-9.7	-5.3	-11.3	-2.6	0.7	-8.2	-6.2	19.8
Ndërtim	-22.7	-13.8	-23.3	-11.2	-9.3	-28.0	-23.1	12.0
Shërbime	7.9	3.3	4.1	3.7	-3.7	-3.0	-1.6	21.5
Gjendja e përgjithshme e biznesit								
Total	0.0	-0.8	-4.1	-3.2	-7.4	-9.3	-5.3	17.4
Industri	-12.2	-10.2	-9.8	-6.0	4.1	-8.7	-2.7	17.3
Ndërtim	-16.2	-11.6	-22.8	-13.8	-7.7	-25.4	-17.9	10.2
Shërbime	11.4	7.1	6.4	2.7	-10.7	-1.9	-0.1	20.8
Prodhimi								
Total	-13.7	-9.6	-15.2	-6.3	-0.4	-13.9	-10.1	15.4
Industri	-11.5	-7.0	-9.8	-1.0	7.4	-7.7	-0.1	15.8
Ndërtim	-15.1	-11.2	-18.7	-9.8	-5.4	-17.9	-16.5	15.2
Konsumatorët								
Situata financiare	-11.4	-2.7	-4.8	-7.0	-13.4	-6.0	-1.2	6.0
Çmimet pas 1 viti, në %	2.2	2.1	2.2	2.2	2.3	2.0	2.2	...
Blerje të mëdha	-49.2	-41.1	-39.8	-43.9	-50.3	-49.0	-38.6	-36.7
Situata e kursimit	-49.4	-42.8	-43.9	-44.2	-50.5	-46.0	-45.6	-41.0

Burimi: Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

*) Me përjashtim të sektorit të konsumatorit, balancat janë të rregulluara sezonalisht.

Grafik 6: Balancat kryesore të vrojtimet të konsumatorit.



Burimi: Vrojtimi i Besimit të Konsumatorëve, Banka e Shqipërisë.

Grafik 7: Balancat kryesore të vrojtimit të bizneseve, të agreguara në nivel ekonomie.



Aneks

Shpjegime metodologjike

-**Balanca** është treguesi që përdoret më shpesh për agregimin e të dhënave cilësore nga vërtetimet. Ajo llogaritet si diferencë midis përqindjes së përgjigjeve pozitive dhe përqindjes së përgjigjeve negative. Balanca shprehet në pikë përqindje.

-**Treguesi i Besimit (TB)** ndërtohet për çdo sektor dhe llogaritet si mesatare e thjeshtë e balancave të rregulluara sezonalisht, të treguesve të cilët kanë korrelacionin më të lartë me serinë e referencës (serinë e të dhënave reale të ekonomisë).

-**Treguesi i Ndjesisë Ekonomike (TNE)** përmbledh të gjitha balancat (13) e përdorura për llogaritjen e treguesve të besimit për të katër sektorët, të peshuara sipas aktivitetit ekonomik. Ai shpreh me anë të një treguesi të vetëm ndjesitë për aktivitetin ekonomik në vend, të dy prej grupeve kryesore ekonomike: bizneset dhe konsumatorët.